



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

***Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit - Ministarstvo Industrije,
Preduzetništva, Trgovine i Inovacija - Ministry of Industry,
Entrepreneurship, Trade and Innovation***

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency

**Thirrje e përsëritur publike për aplikim në stendën shtetërore të Kosovës në panairin
“Light + Building 2026”**

8 - 13 mars 2026
Adresa: Frankfurt, Gjermani

Me qëllim të promovimit të kompanive kosovare dhe gjetjes së tregjeve të reja ndërkombëtare për eksport të produkteve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) fton bizneset prodhuese nga sektori elektrik, sisteme sigurie & Smart Home, përpunimi i plastikës dhe metalit për instalime elektrike (kabllove elektrike, gypa për instalime elektrike dhe ormanë elektrike etj.) dhe të aplikojnë përmes kësaj thirrjeje për të qenë pjesë e këtij aktiviteti ndërkombëtar. Në kuadër të këtij panairi, KIESA siguron hapësirën ekspozuese. KIESA do të mbulojë shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e stendës, regjistrimin e deri në 5 bizneseve pjesëmarrëse, shpenzimet e energjisë elektrike, pastrimin ditor, dhe shërbime të tjera teknike. Ndërkaq, shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit dhe dërgimit të materialeve promovuese do të mbuloohen nga vetë bizneset pjesëmarrëse. Afati për aplikim për pjesëmarrje është deri më 01.03.2026. Dokumentet e plotësuara si në vijim do të konsiderohen për vlerësim.

1. Aplikacioni i plotësuar më të dhënat bazike të subjektit aplikues;
2. Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës (kërkohet: certifikata e regjistrimit me informatat mbi biznesin);
3. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
4. Vërtetimin nga gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime (kërkohet origjinali, jo me i vjetër se 30 ditë);
5. Deklaratën nën betim;

6. Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2024 nga Administrata Tatimore e Kosovës (kërkohet: gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tjera nga ATK); dhe
7. Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj ATK, jo më e vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit.

Në mungesë të cilit do dokument të kërkuar në listën e mësipërme aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet. Për këtë aktivitetet sipas kriterëve në vijim dhe vlerësimit të pikëve do të për zgjidhen 5 subjekte, nëse aplikojnë më shumë subjekte të përgjegjshme do të përpilohet edhe lista rezervë në mënyrë që të zëvendësohet sipas vlersimit nëse ndonjëra kompani tërhiqet për çfarëdo arsye:

Kriteret e vlerësimit:

- Produktet që subjekti aplikues do të ju ofrojë blerësve potencial në panair, maksimum 10 pikë:
 - 1 pikë për 1 produkt
 - 3 pikë për 2 produkte
 - 5 pikë për 3 produkte
 - 7 pikë për 4 produkte dhe
 - 10 pikë për 5 e më shumë produkte.
- Njohja e gjuhëve të huaja dhe aftësitë prezantuese, maksimum 10 pikë:
 - Gjuhë Angleze 5 pikë
 - Gjuhë Gjermane 4 pikë dhe
 - Gjuhë tjera 1 pikë.
- Materialet promovuese në gjuhët e huaja, maksimum 10 pikë:
 - Gjuhë Angleze 4 pikë
 - Gjuhë Gjermane 4 pikë dhe
 - Gjuhë tjera 2 pikë.
- Shtetet ku janë eksportuar produktet e subjektit aplikues gjatë vitit 2024/25, maksimum 10 pikë:
 - Shtetet e BE-së 5 pikë
 - Shtetet e CEFTA-së 3 pikë dhe
 - Shtetet tjera 2 pikë.

Certifikime ndërkombëtare të subjektit, maksimum 5 pikë:

- ISO 3 pikë dhe
- Certifikime tjera 2 pikë.
- Paraqitja e subjektit aplikues në panairë apo dhe B2B takime në 5 vitet e fundit, maksimum 5 pikë:
 - 1 deri në 3 panairë 3 pikë dhe
 - 4 deri në 6 panairë 5 pikë.

Qarkullimi vjetor i subjektit aplikues gjatë vitit fiskal 2024, maksimumi 10 pikë:

- 0 - 500.000 euro 4 pikë
- 500,001 – 1,000,000 euro 8 pikë dhe
- > 1,000.000 euro 10 pikë.

Më 27.02.2026, në ora 14:00, në sallën e takimeve të KIESA-s, organizohet sesioni informues ku zyrtarët e KIESA-s do tu përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair. Subjektet që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në këtë takim.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë bashke me dokumentet e tjera në mënyrë elektronike më së largu deri më 01.03.2026 në e-mail adresën: Export.Kies@rks-gov.net

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informimi dhe pyetësori për shprehje të interesit mund të merren në KIESA-MINTI apo të shkarkohen nga faqet e internetit: mint.rks-gov.net dhe kies.rks-gov.net apo në e-mail adresën: Export.Kies@rks-gov.net